



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 23.02.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “**Blerje Pajisje mobilimi**”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Mobilje**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **28,841,800** (njëzet e tetë milion e tetëqind e dyzet e një mijë e tetëqind) **Lekë, pa T.V.SH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertes sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave,*

autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.*  
**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 95% e vlerës së fondit limit të kontratës objekt prokurimi**. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes”.*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për*

tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që 4 detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që

ushtrjnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë **jo më të vogël se 39% të vlerës së përlogaritur fondit limit që prokurohet**.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- a) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:  
Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që 6 do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2.** Operatori Ekonomik për të realizuar prodhimin/montimin dhe shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Nga të cilët:

- 1 arkitekt ose inxhinier druri - të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme CV, diplomë përkatëse,
- 2 shofer
- 2 Marangoz, 1 saldator
- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune përkatëse si dhe leje drejtimi per secilin.
- Për punonjësit e punësuar marangoz të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.
- Per punonjësit e punësuar saldator të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe deshmitë e kualifikimit profesional teknik për secilin.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga ana e AK është kërkuar një numër punonjësish prej 10 personash, sepse kontrata është komplekse, me shume artikuj ku kërkohen punonjës të specializuar në procese specifike të prodhimit të mallrave objekt prokurimi. Shume artikuj janë prodhim sipas përmasave të përcaktuara në planet përkatëse të mobilimit që kërkon precision, cilësi dhe shpejtësi në të njëjtën kohë. Të gjithë artikujt janë parashikuar të jenë Furnizim Vendorsje, pra përveç prodhimit dhe shpërndarjes kemi të përfshirë edhe procesin e montimit që kërkon punonjës të tjerë duke patur parasysh edhe faktin qe kemi të bëjmë me ambiente që gjenden në pozicione të ndryshme të “Posta Shqiptare” Sh.a. me largësi të konsiderueshme nga njeri tjetri.

Konkretisht analiza në lidhje me numrim e punonjësve për rastin kur operatori është prodhues dhe tregtar paraqitet si më poshtë vijon:

Në bazë të përlllogaritjeve, nisur nga sasia e produkteve të kërkuara, nevojitet staf, si më poshtë vijon:

Nisur nga volumi i mallrave, llogariten rrugë transporti me kamionë mbi 1.5 ton, kjo për shkak të distancave të zyrave Postare të “Posta Shqiptare” Sh.a. dhe pozicionit gjeografik të tyre.

Shoferë- 2 persona

Punëtorë ngarkim shkarkimi, montim - 4 punëtorë

Total- 10 punonjes

**Argumentimi:** Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 5, (i ndryshuar).Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale,autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën....”*

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

a) Kërkesa për Specialistë të certifikuar garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin me cilësi dhe në kohë të kontratës në tërësi.

b) Kërkesa lidhet me stafin garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë e duhura profesionale për realizimin e kontratës.

c) Bazuar në objektin e prokurimit, volumin kërkesa prej të paktën 1 (një) arkitekt ose 1 (një) inxhinier druri janë në përpjestim me natyrën dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe vlerën e kontratës. Prania e arkitektit ose inxhinierit të sipërcituar, i jep siguri AK se Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës.

Objekti i procedues se prokurimit “**Blerje Pajisje mobilimi**” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të mobiljeve pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e pajisjeve dhe orendi mobimi për objektet arsimore. Punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm, duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përveç mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të një stafi të konsiderueshëm për realizimin në kohën e duhur të lëvrimit dhe instalimit të tyre pranë objekteve postare. Procedura e prokurimit në fjalë,

referuar specifitimeve teknike, është lehtësisht e kuptueshme që artikujt objekt prokurimi nuk janë artikuj që gjenden në subjekte tregtare të tilla si pika shitje pasi kanë përmasa dhe specifika të ndryshme referuese dhe duhet të përshtaten me vendet ku do të vendosen/montohen, pra do duhet të merret serish përmasat dhe të prodhohen në mënyrë që të përshtaten me kërkesat e AK.

Për sa më sipër, AK nuk është në gjendje të identifikojë pra nuk ka në staf ekspert të fushës inxhinierë druri për të mundësuar njohjen e saktë të materialit të produktit që do të ofrohet, si dhe ndjekjen hap pas hapi të procesit të prodhimit të tyre konform specifitimeve teknike. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

### **2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi.**

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa për **ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi** është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 5/ç, (i ndryshuar).Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale,autoriteti/enti kontraktor kërkon:

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën....”*

Rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Kërkesa për **ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi** garantojnë Autoritetin Kontraktor, që referuar objektit të procedurës së prokurimit “**Blerje Pajisje mobilimi**” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të mobiljeve pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një ambient si për prodhimin po ashtu edhe për magazinimin e mallrave objekt prokurimi për të bërë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e pajisjeve të mobilimit.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2 (dy) mjete transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës.

Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

- Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi)
- Mjetet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit
- Për mjetet e transportit duhet të paraqiten edhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore).

***Shënim:*** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend dorëzimit të tyre në destinacionin përkates, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në



dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Janë kërkuar dy kamion të përshtatshëm për transport mallrash për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjete e nevojshëm për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qene se kontrata eshte komplekse me shume artikuj të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes. Për ngjyrat e mobiljeve duhet të kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë adresat e përcaktuara në plan shpërndarje.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e cilesise se punimeve **ISO 9001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te paraqesë **Certifikate ISO 14001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **ISO 45001-2018 ose ekuivalente** Për sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne punë (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt

marrëveshjes). AK do të pranojë dhe OE, të cilët disponojnë certifikatën me standardin e azhurnuar dhe ekuivalente nga standartet shqiptare **ISO 45001-2018**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:

**ISO 9001- 2015** - Certifikatë e cilësisë së punimeve

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin **Pajisje mobilimi** për ambientet e zyrave të shërbimeve postare ndaj qytetarëve, me qëllim furnizimin me pajisje cilësore nisur nga fakti që bëhet fjalë për ambiente ofrim shërbimi ndaj qytetarëve dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**ISO 14001-2015** – Certifikate për menaxhimin e sistemit mjedisor

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin **Pajisje mobilimi** për ambientet e zyrave të shërbimeve postare ndaj qytetarëve dhe duke qenë se ky proces sjell ndikime në mjedis vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**ISO 45001-2018** - Certificate për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndetit

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe operatorët ekonomikë në këtë fushë duhet të zotërojnë një numër të lartë makinerish dhe duhet të kenë të punësuar kryesisht një numër të lartë punonjësish vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë Për sistemin e integruar të menaxhimit **BS PAS 99:2012** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

**Argumentim:** Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:

## **PAS 99:2012** - Certifikatë për sistemin e integruar të mënaxhimit

PAS 99 është një dokument që mund të përdoret për të mbështetur integrimin e një sistemi menaxhimi. Ai siguron një strukturë për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të integruar të menaxhimit. Certifikimi i PAS 99 konfirmon faktin që shoqëria ka një qasje të saktë ndaj zhvillimit dhe zbatimit të sistemit të saj të menaxhimit të integruar.

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe operatorët ekonomikë në këtë fushë duhet të zotërojnë një numër të lartë makinerish dhe duhet të kenë të punësuar punonjës me staf të kualifikuar, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**2.3.11** Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqese certifikatat e cilësisë dhe raportet e testimit së produktit, të vlefshme, si më poshtë:

**Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente**

• **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018,e vlefshme ose ekuivalente.**

**Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

**Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

*Çertifikatat e cilësisë së produktit duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e kerkuara duhet të jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e cilësisë duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga një BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njejtën performance (qellim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi

*kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Këto kërkesa janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi dhe ka të bëjë me testet funksionale, të përshtatshmerisë të funksionalitetit dhe të qëndrueshmerisë gjatë përdorimit.*

**Karrige zyre statike: SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 e vlefshme ose ekuivalente**, standart që përcakton dimensionet funksionale të **Karrige zyre statike** për përdorim në ambientet e zyrave postare, standart që përdoret për kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë për karriget e punës në zyrë. Nuk zbatohet për vendet e tjera në zonën e zyrës për të cilat ekzistojnë standarde të tjera evropiane. Kërkesat bazohen në përdorimin për 8 orë në ditë nga persona që peshojnë deri në 110 kg. Shtojca A (informative) përmban ngarkesat, masat dhe ciklet për testet funksionale. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti është i sigurtë për një përdorim të tillë.

• **Karrige rrotulluese (zyre): SSH/ EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018,e vlefshme ose ekuivalente**, standart që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me dimensionet që duhet të ketë një karrige zyre për përdorim të zakonshëm në mënyrë që të sigurohet një qëndrim i përshtatshëm për të punuar dhe gjithashtu përshkruan edhe metodat e testeve të kryera për përcaktimin e tyre. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti i prodhuar respekton këto dimensionet.

**SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018**, standart që specifikon kërkesat që duhet të plotësojnë këto karrige për sa i përket sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë për një përdorim rreth 8 orë në ditë dhe për një person që peshon deri në 110 kg. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti është i sigurtë për një përdorim të tillë.

Këto standarde shoqërohen bashkë. Një certifikatë e tillë nënkupton që mobilja e prodhuar i plotëson këto standarde.

**Dollap (Raft) : SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.** standart që specifikon kërkesat e sigurisë për mobiljet e ruajtjes së zyrës, metodat e provës për përcaktimin e forcës së strukturës së mobiljeve të zyrës me qëndrim të lirë, si dhe qëndrueshmërinë e njësisve të lira.

**SSH/ EN 14073-1:2004, EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004**, standart që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me **përcaktimin e forcës dhe qëndrueshmërisë së pjesëve lëvizëse të Dollapit (Raft)**. në mënyrë që të sigurohet përballimin e një **përdorimin normal funksional, si dhe keqpërdorimet që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të ndodhin.**

Ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në **Dollap (Raft)**.

**Dollap metalike: SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004, e vlefshme ose ekuivalente.**

Standart që specifikon kërkesat e sigurisë për Dollap metalike, metodat e provës për përcaktimin e forcës së strukturës së mobiljeve të zyrës me qëndrim të lirë, si dhe qëndrueshmërinë e njësisve të lira.

**SSH/ EN 14073-3:2004, EN 14074:2004**, standart që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me **përcaktimin e forcës dhe qëndrueshmërisë së pjesëve lëvizëse të Dollapit metalik**, në mënyrë që të sigurohet përballimin e një **përdorimit normal funksional, si dhe keqpërdorimet që mund të priten në mënyrë të arsyeshme të ndodhin.**

Ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në **Dollapit metalik**.

**2.3.12** Operatorët Ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin mostra per artikujt:

- **Karrige zyre (tip statike)**
- **Karrige rrotulluese**
- **Dollap druri dokumentash**

brenda **orës 10.00 të datës 13/03/2024**, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse. Kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të kërkuara, me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesën për prokurim.

Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, përben kusht skualifikues.

**Mostrat (Kampionet) duhet të dorëzohen në ambjentet e Shpërndarësisë së Filialit Tiranë (ish Qendra Tranzite) Rr. “Pjetër Dungu”, (Njësia Bashkiake Nr. 4, Kinostudio), Tiranë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 6 gërma a), gërma c) e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit të sipërcituara ka për qëllim verifikimin e përputhueshmërisë së produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë të interesuar me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi me sukses.

*Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Njësia e Prokurimit gjykon se dorëzimi i mostrave është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

Nga ana e AK janë kërkuar mostra në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur duke qenë se nëpërmjet kërkesës për dorëzim mostrash AK krijon siguri të plotë dhe vërteton plotësisht përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përputhshmërinë e mallrave të kërkuar me ato të ofertuar nga operatori ekonomik.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim:* Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes:* Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose 18 produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të procedurës objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për **Pajisje Mobilimi**.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

## **VLERA LIMIT E KONTRATËS,**

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është hartuar bazuar në mesataren e studimit të tregut, në mbështetj dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: b) studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim. Praktikë e cila është e dokumentuar me dokumentacion shkresor në dosjen e prokurimit.

*Shënim:* Të gjitha dokumentet të cilat janë për tu paraqitur nga operatorët ekonomik dhe janë të përfshira në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të Shtojca 8, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura nëse deklarohen në këtë formularë sikurse kërkohet dhe në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues (ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë) që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.